



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 83 Datë 25/11/2011

PER MIRATIMIN E INVESTIMIT NE OBJEKTIN RIKONSTRUKSION I
SHESHIT PARA KATEDRALES PER 2011-2012

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga ekzekutivi i Bashkisë Korçë «Për miratimin e investimit në objektin Rikonstruksion i sheshit para Katedrales për 2011-2012 » në zbatim të ligjit nr.8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë», ligjit nr 10355 datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", Udhëzimit nr. 4 datë 27.1.2011 "Për zbatimin e buxhetit 2011", VKB nr. 44 datë 28.7.2011 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të varesise per vitin 2011, VKB nr. 64 datë 5.10.2011 "Mbi programin buxhetor afatmesëm (PBA) 2012-2014 për Bashkinë Korçë, Urdhrin nr. 226 datë 16.11.2011 "Për ndryshimin e vlerës së planifikuar për objektin "Rikonstruksion i sheshit para kinema Majestik" si dhe VKB nr. 16 datë 9.3.2011 "Për përcaktimin e prioriteteve të investimeve për vitin 2011", si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

VENDOSI

1. Të miratojë investimin për objektin "Rikonstruksion i sheshit para Katedrales" në vlerën 80,000 mijë lekë për vitet 2011-2012. Ky investim do financohet në 2 vite buxhetore nga të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë i detajuar si më poshtë:

Për vitin 2011	4,521,519 lekë
Për vitin 2012	75,478,481 lekë

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Prokurimeve, Drejtoria e Financës dhe DPPKZHU.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Kryetari

Ilirjan PENDAVINJI